LIGJ
Nr.9945, datë 26.6.2008

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002 "PËR AKCIZAT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, në nenin 19 "Përjashtimet" bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas shkronjës "d" shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:

"e) gazoili është shitur për anijet e peshkimit në sasitë, kushtet dhe kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.".

2. Në pikën 2, shkronja "c" shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5808, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi